



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

RREGULLORE
(QRK) Nr. 35/2024 PËR DETYRAT, PËRBËRJEN, FUNKSIONIMIN DHE
KOMPENSIMIN E KOMISIONEVE NË AGJENCINË ANTIDOPING¹

¹ Rregullorja (QRK) Nr. 35/2024 për Detyrat, Përbërjen, Funkcionimin dhe Kompensimin e Komisioneve në Agjencinë Antidoping, është miratuar në mbledhjen e 238-të, të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 05/238, të datës 18.12.2024.

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 10 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 08/L-152 për Anti Dopingun, nenit 8, paragrafi 4, nën-paragrafi 4.5, të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës,

nxjerr:

**RREGULLORE
(QRK) Nr. 35/2024 PËR DETYRAT, PËRBËRJEN, FUNKSIONIMIN DHE
KOMPENSIMIN E KOMISIONEVE NË AGJENCINË ANTIDOPING**

**Neni 1
Qëllimi**

Me këtë rregullore përcaktohen detyrat, përbërja, funksionimi dhe kompensimi i komisioneve të Agjencisë Antidoping.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Kjo rregullore zbatohet nga personat fizikë dhe juridikë në Republikën e Kosovës.

**Neni 3
Përkufizimet**

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin Nr. 08/L-152 për Anti Dopingun dhe Rregullat Kombëtare për Antidoping.

**Neni 4
Komisionet e Agjencisë**

1. Agjencia themelon komisionet e përhershme si në vijim:

1.1. Komisionin për Përgjashtimin e Përdorimit Terapeutik; dhe

1.2. Komisionin Disiplinor.

Neni 5
Përbërja e Komisionit për Përrjashtimin e Përdorimit Terapeutik (PPT), mandati, përrgjedhja dhe kompensimi

1. Komisioni për Përrjashtimin e Përdorimit Terapeutik përrbëhet nga 5 anëtarë, njëri prej të cilëve emërohet si kryesues.
2. Anëtarët e këtij komisioni duhet të jenë mjekë specialistë në fushat si: mjekësi interne ose kardiologji, endokrinologji, mjekësi sportive, gjinekologji dhe obstetrikë, pediatri dhe psikiatri. Të njëjtut duhet të kenë përrvojë në kujdesin dhe trajtimin e sportistëve si dhe njohuri të shëndosha të mjekësisë klinike, mjekësisë sportive dhe ushtrimeve.
3. Anëtarët e Komisionit për Përrjashtimin e Përdorimit Terapeutik delegohen nga institucionet përrkatëse shëndetësore me kërkesë të Agjencisë, të cilët emërohen nga drejtori i Agjencisë.
4. Para se të shërbejë si anëtar i Komisionit për Përrjashtimin e Përdorimit Terapeutik, secili anëtar duhet të nënshkruajë një deklaratë mbi konfliktin e interesit dhe konfidencialitetit.
5. Zëvendësimi i anëtarëve të Komisionit për Përrjashtimin e Përdorimit Terapeutik bëhet me kërkesë të kryesuesit pasi që i njëjti konstaton shkeljet si në vijim: mungesë të paarsyeshme në tri mbledhje të njëpasnjëshme, shkelje të rregullave antidoping dhe thyerje të kodit të etikës.
6. Mandati i anëtarëve të Komisionit për Përrjashtimin e Përdorimit Terapeutik është katër (4) vjet, me mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat.
7. Rolin e sekretariatit të komisionit do ta luajë Agjencia Antidoping.

Neni 6
Detyrat e Komisionit për Përrjashtimin e Përdorimit Terapeutik

1. Detyrat e Komisionit për Përrjashtimin e përdorimit Terapeutik janë:
 - 1.1. Komisioni vlerëson dhe vendos për aplikimin për PPT për sportistët që nuk janë sportist ndërkombëtar në përputhje me dispozitat përrkatëse të Standardit ndërkombëtar për përrjashtimet e përdorimit terapeutik dhe jo më vonë se njëzet e një (21) ditë nga data e marrjes së një aplikimi të plotë (përveç në rrethana të jashtëzakonshme). Kur aplikimi është bërë në një kohë të arsyeshme para një ngjarjeje, komisioni duhet të bëjë përrpjekjet e tij më të mira për të nxjerrë vendimin e tij para fillimit të ngjarjes;
 - 1.2. Para se të shqyrtohet një aplikim për PPT, secili anëtar duhet t'i paraqesë kryesuesit çdo rrethanë që mund të ndikojë në paanësinë e tyre në lidhje me sportistin që bën aplikimin;
 - 1.3. Një anëtar i Komisionit për PPT nuk mund të shërbejë si anëtar i komisionit me të drejtë vote nëse ka ndonjë rrethanë që ka të ngjarë të ndikojë në paanësinë e panelit për PPT;

1.4.Vendimi i Komisionit për PPT është vendim përfundimtar i Agjencisë dhe mund të apelohe në shkallën e dytë në KAS në përputhje me nenin 4.4.6 të Kodit, në afat prej njëzet e një (21) ditësh nga pranimi i vendimit nga pala;

1.5.Vendimi i Komisionit për PPT të Agjencisë do t'i kumtohet me shkrim sportistit, dhe duhet t'i vihet në dispozicion WADA-s dhe organizatave të tjera antidoping nëpërmjet ADAMS në përputhje me Standardin ndërkombëtar për përjashtimet e përdorimit terapeutik.

Neni 7 **Aplikimi për PPT retroaktive**

Një sportist mund të aplikojë për një PPT retroaktive për një substancë të ndaluar ose metodë të ndaluar pasi të ketë përdorur një substancë të ndaluar ose metodën e ndaluar në fjalë, në përputhje me dispozitat përkatëse të Standardit Ndërkombëtar për Përjashtimet e Përdorimit Terapeutik.

Neni 8 **Aprovimi i PPT -së**

1. Një PPT e dhënë nga Agjencia është e vlefshme në nivel kombëtar në baza globale dhe nuk ka nevojë të njihet zyrtarisht nga organizata të tjera kombëtare anti-doping në përputhje me dispozitat përkatëse të Standardit Ndërkombëtar për Përjashtimet e Përdorimit Terapeutik.

2.Një PPT nuk është e automatikisht e vlefshme në nivelin ndërkombëtar nëse sportisti bëhet një sportist i këtij niveli ose garon në një ngjarje ndërkombëtare por vetëm nëse njihet nga federata ndërkombëtare përkatëse ose Organizata e Ngjarjeve të Mëdha në përputhje me Standardin ndërkombëtar për përjashtimet e përdorimit terapeutik:

2.1 Njohja e një TUE në nivel ndërkombëtar rregullohet nga dispozitat përkatëse të përcaktuara nga Kodi dhe Standardi Ndërkombëtar për Përjashtimet e Përdorimit Terapeutik.

3.Një PPT valide e lëshuar nga organizatat antidoping njihet nga Agjencia pa pasur nevojë për procedura të tjera shtesë për konfirmim.

Neni 9 **Skadimi, tërheqja ose anulimi i një PPT -je**

1.Një PPT e dhënë në pajtim me këtë rregullore dhe Rregullat Kombëtare Antidoping: (a) skadon automatikisht në fund të çdo afati të dhënë, pa qenë e nevojshme të bëhetndonjë njoftim apo formalitet tjetër; (b) mund të shfuqizohet nëse sportisti nuk përmbushmenjëherë kërkesat ose kushtet e vendosura nga Komisioni për PPT për lëshimin e PPT -së; (c) mund të tërhiqet nga Komisioni për PPT nëse më vonë vendoset që kriteret për dhënien e PPT -së faktikisht nuk përmbushen; ose (d) mund të anulohet pas rishikimit të WADA-s ose me apelim.

2.Në rastet e tilla sportisti nuk i nënshtrohet asnjë pasoje bazuar në përdorimin ose zotërimin e tij ose administrimin e substancës së ndaluar ose metodës së ndaluar në fjalë në pajtim me PPT -në para datës faktike të skadimit, shfuqizimit, tërheqjes ose anulimit të PPT -së.

3.Rishikimi sipas nenit 5.1.1.1 të Standardit ndërkombëtar për menaxhimin e rezultateve të një konstatimi analitik anormal përfshin shqyrtimin nëse një konstatim i tillë është në pajtim me përdorimin e substancës së ndaluar ose metodës së ndaluar para asaj date, aktivitet në të cilin nuk konfirmohet asnjë shkelje e rregullave antidoping.

Neni 10

Përbërja e Komisionit Disiplinor, mandati përzgjedhja dhe kompensimi

1. Komisioni Disiplinor përbëhet nga 5 anëtarë. Kryesuesi i Komisionit emërohet nga drejtori i Agjencisë për secilin rast veq e veq, sipas renditjes në vendimin e emrimit të Komisionit. Në rast konflikti të interesit, atëherë Kryesues emrohet anëtari sipas radhës.

2. Anëtarët e Komisionit Disiplinor duhet të jenë nga fusha përkatëse për sport, shëndetësi, drejtësi, siguri dhe komuniteti i sportit në Kosovë.

3.Anëtarët e Komisionit Disiplinor emërohen nga Drejtori i Agjencisë sipas paragrafit 2 të këtij neni.

4.Para se të shërbejë si anëtar i Komisionit Disiplinor, secili anëtar duhet të nënshkruajë një deklaratë mbi konfliktin e interesit dhe konfidencialitetin në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe ISRM.

5.Zëvendësimi i anëtarëve të Komisionit Disiplinor bëhet me kërkesë të kryesuesit pasiqë i njëjti konstaton shkeljet si në vijim: mungesë të paarsyeshme në tri mbledhje të njëpasnjëshme, shkelje të rregullave antidoping dhe thyerje e kodit të etikës.

6.Mandati i anëtarëve të Komisionit Disiplinor është katër (4) vjet, me mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat.

7.Rolin e sekretariatit të Komisionit Disiplinor do ta luajë Agjencia Antidoping.

Neni 11

Detyrat e Komisionit Disiplinor

1.Detyrat e Komisionit Disiplinor janë:

1.1. Komisioni Disiplinor vlerëson dhe vendos mbi çështjen përkatëse e cila paraqitet në Komisionin Disiplinor nga Agjencia;

1.2. Komisioni Disiplinor mban seanca dëgjimore me palët në procedurë konform Kodit dhe Rregullave Kombëtare Antidoping;

1.3. I gjithë Menaxhimit i Rezultateve për rastin përkatëse duhet të përfundoj brenda gjashtë muajve nga njoftimi (me përjashtim të rasteve që përfshijnë çështje komplekse ose vonesa që nuk janë në kontrollin e Agjencisë;

1.4. Para se të shqyrtohet një aplikim i lëndës përkatëse, secili anëtar duhet t'i paraqes kryesuesit çdo rrethanë që mund të ndikojë në paanësinë e tyre në lidhje me rastin që shqyrtohet;

1.5. Një anëtar i Komisionit Disiplinor nuk mund të shërbejë si anëtar i komisionit me të drejtë vote nëse ka ndonjë rrethanë që ka të ngjarë të ndikojë në paanësinë e vendimit;

1.6. Vendimi i Komisionit Disiplinor është vendim përfundimtar i Agjencisë dhe mund të apelohe në shkallën e dytë në KAS në përputhje me nenin 4.4.6 të Kodit, në afat prej njëzet e një (21) ditësh nga pranimi i vendimit nga pala;

1.7. Vendimet do t'i kumtohen sportistit ose personit tjetër dhe organizatave të tjera antidoping me të drejtë ankimi sipas Kodit dhe Rregullave Kombëtare Antidoping dhe do të raportohen menjëherë në ADAMS.

Neni 12

Kompensimi i anëtarëve të komisioneve

1. Anëtarët e komisioneve të Agjencisë kompensohen për punën e tyre.
2. Kompensimi i anëtarëve të komisioneve të cilët marrin pagë nga buxheti i shtetit bëhet sipas Ligjit të Pagave të Republikës së Kosovës.
3. Anëtari i Komisionit Disiplinor nga Komuniteti i Sportit në Kosovë kompensohet në mënyrë ekuivalente siç kompensohen anëtarët e tjerë.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

19/12/2024